



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA



PROJEKTI FITUES ME TITULL:

**“DIDAKTIKA DIGJITALE E MËSIMDHËNIES/NXËNIES DHE
KËRKIMIT SHKENCOR NË UT - (DiDiRes)”**

**FINANCUAR NGA AGJENCIA E KËRKIMIT, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
NË KUADËR TË PROJEKTEVE KOMBËTARE TË KËRKIMIT DHE TË
ZHVILLIMIT (PKKZH) 2023**

AKKSHI

EKIPI I PROJEKTIT:

Prof. Dr. Esmeralda Kromidha (drejtuese e projektit)

Prof. Asoc. Dr. Anida Kisi

Prof. Asoc. Dr. Elona Toro

Prof. Asoc. Dr. Ogerta Koruti

Prof. Asoc. Dr. Daniela Hasa

Dr. Migena Sejdini

Znj. Klodeta Alushani

PERIUDHA E ZBATIMIT TË PROJEKTIT:

Shtator 2023 – Gusht 2024

PËRSHKRIM I PROJEKTIT

Ky projekt është një kërkim shkencor që synon të ofrojë njohuri dhe rekomandime të zbatueshme për pedagogët, studentët e ciklit të dytë dhe doktorantët.



Qëllimi përfundimtar është të kontribuojë në përmirësimin e vazhdueshëm të praktikave akademike në studimet e ciklit të dytë dhe të doktoraturës, duke nxitur një mjedis ku teknologjia shërben si një katalizator për përsosmërinë akademike dhe inovacionin kërkimor.

QËLLIMI

- Ekzaminimi në mënyrë gjithëpërfshirëse i integritit të teknologjisë në metodologjitë e mësimdhënies të përdorur në kuadër të ciklit të dytë të studimeve dhe programeve të doktoraturës.
- Kryerja e kërkimeve shkencore mbi integrimin e teknologjisë dixhitale në metodologjitë e mësimdhënies/nxënies dhe zhvillimi i aftësive digjitale të personelit akademik të FGJH, UT-së;
- Zhvillimi i kulturës së projektit dhe qasjes së zgjidhjes së problemeve tek studiuesit e rinj si dhe në mësimdhënie, duke përdorur teknologjitë;



OBJEKTIVAT

- 🎯 Krijimi i një panoramë të përgjithshme mbi situatën aktuale të përdorimit të teknologjive në mësimdhënie/mësimnxënie si edhe kërkimin shkencor në Universitetin e Tiranës nëpërmjet shembujve në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja dhe të propozojë zgjidhje për përmirësimin dhe/ose përshtatjen e metodave të reja të mësimdhënies dhe të nxënit;
- 🎯 Evidentimi i nevojave të personelit akademik/studentëve në përdorimin teknologjisë;
- 🎯 Vlerësimi dhe përmirësimi i përdorimit të teknologjive si në kontekstet e mësimdhënies ashtu edhe në ato kërkimore specifike për ciklin e dytë të studimeve dhe studentët e doktoraturës.
- 🎯 Diskutime në tavolina të rrumbullakta me palët e interesuara për të kuptuar sfidat dhe mundësitë të paraqitura në këto nivele akademike dhe identifikimin e strategjive që mund të optimizojnë integrimin e teknologjisë, duke nxitur kështu një mjedis mësimor më dinamik dhe efektiv.
- 🎯 Mbështetje institucionale me një udhëzues/guidë për të promovuar integrimin e teknologjive në procesin e mësimdhënies/të nxënit;

REZULTATET

1. Plotësimi i një pyetësoni me pedagogë dhe studentë të gjuhëve të huaja të Universitetit të Tiranës;
2. Analiza e nevojave dhe shkrimi i një raporti që do të shërbejë si bazë për diskutimet dhe referimet në tryeza të rrubullakta;
3. Diskutim me pedagogë, studentë dhe ekspertë të metodave bashkëkohore të mësimdhënies/nxënies bazuar në nevojat e nxjerra nga pyetësoni;
4. Publikimi i hulumtimit me praktikat më të mira për aftësitë digjitale të kërkuesve të rinj;
5. Shkrimi i të paktën 2 artikujve shkencorë nga doktorantët e përfshirë në këtë projekt.

